



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.595/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj, kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën Ardiana Isufi kryesuese e Ekipit të Numërimit, me seli në Drenas, paraqitur kundër, Qendrës Komunale të Numërimit në Komunën e Drenas, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të fletëvotimeve, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 18.02.2025, merr këtë,

### V E N D I M

Refuzohet e pa bazuar ankesa Anr.595/2025 e datës 16.02.2025, të parashtruar nga Ardiana Isufi kryesuese e Ekipit të Numërimit, me seli në Drenas, të paraqitur kundër Qendrës Komunale të Numërimit në Komunën e Drenasit, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të fletëvotimeve, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

### A r s y e t i m

Me datë 16.02.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën nga Ardiana Isufi, si kryesuese e Ekipit të Numërimit në Drenas, në të cilën thekson se si kryesuese në QNR te tavolina numër 2, gjatë shfletimit të fletëvotimeve dhe konfirmimit të tyre në të vlefshme dhe të pavlefshme, së bashku me ekipin tonë shqyrtuam dhe analizuam të gjitha fletëvotimet dhe tek fletëvotimet e PDK-së kishte disa fletëvotime të pavlefshme të pjesa e kandidatëve për deputet dhe në të gjitha to ishte prezent edhe nr. 51 Petrit Hajdari - kandidat për deputet, dhe dyshojmë që votat i janë dëmtuar. Kërkojmë verifikim të kamerës së qendrës së vendvotimit 0316/02 në ditën e zgjedhjeve nga hapja e qendrës së vendvotimit e deri në mbyllje të kutisë së votimit.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur nga KQZ, theksohet se “Me datën 15.02.2025 KKZ ka proceduar rutinë e votimit Nr. 0316/02 për numërim ku ekipet e numërimit ndërrimi i dytë PASI QË KA MBYLLUR KUTINË E VOTIMIT në fjalë Kryesuesja e ekipit të numërimit (Ardiana Isufi) ka paraqitur shqetësim se “Gjatë numërimit është vërejtur se 13 fletëvotime janë shpallur të pavlefshme, me dyshimin e bazuar se ato janë dëmtuar qëllimisht. Kjo për arsye se në secilën prej tyre ka qenë i votuar kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) me nr. 51. Ky fakt ngjall shqetësim për mundësinë e ndërhyrjeve gjatë procesit të numërimit për subjektet politike në vendvotim, sepse janë votuar 11 kandidat për deputet dyshohet se janë dëmtuar qëllimshëm për të dëmtuar një kandidat. Me që kutia ishte tashme e

përfunduar sipas procedurave dhe përgjegjësive të ekipeve të numërimit KKZ i ka thanë se ka të drejtën të bëjë ankesë në PZAP, dhe sipas legjislacionit të ri numërimi në QKN është krejtësisht nën përgjegjësinë e ekipeve të numërimit. KKZ, nuk ka pranuar asnjë raport, informatë, apo shprehje të pakënaqësive eventuale as në ditën e zgjedhjeve, as pas ditës së zgjedhjeve as në procesin e fillimit të numërimit të votave për kandidat në QKN, dhe se për këtë KKZ nuk ka hasur në asnjë provë apo dëshmi eventuale për apo lidhur me pretendimet e palës ankuese. Ndërsa, sa i përket pretendimeve të ankueses, këto deklarime i ka bërë vetëm pasi e ka mbyllur kutinë e votimit. Ankuesja, do duhet që në momentin e parë të raportonte tek KKZ, mirëpo tanimë ne si KKZ nuk kemi të drejtë ta hapim kutinë e votimit për të bërë vlerësim të drejtë të të gjitha fletëvotimeve në këtë vendvotim si dhe vlefshmërinë e tyre”.

KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor duk përfshirë edhe kamerat e sigurisë, momentalisht gjendet në QKN të komunave përkatëse, mirëpo pas përfundimit të gjithë procesit të punës së QKN i njëjti material zgjedhor dorëzohet nga QKN në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore, përgjigjet në ankesë vëren se:

#### **Ankesa është e pa bazuar.**

Pretendimet e parashtruara në ankesë Anr.595/2025, nga Ardiana Isufi, si kryesuese e Ekipit të Numërimit në Drenas, në të cilën thekson se si kryesuese në QNR te tavolina numër 2, gjatë shfletimit të fletëvotimeve dhe konfirmimit të tyre në të vlefshme dhe të pavlefshme, së bashku me ekipin tonë shqyrtuam dhe analizuam të gjitha fletëvotimet dhe tek fletëvotimet e PDK-së kishte disa fletëvotime të pavlefshme të pjesa e kandidatëve për deputet dhe në të gjitha to ishte prezent edhe nr. 51 Petrit Hajdari - kandidat për deputet, dhe dyshojmë që votat i janë dëmtuar.

Po ashtu edhe nga përgjigja e KQZ-KKZ, se të njëjtit nuk kanë pranuar asnjë raport, informatë, apo shprehje të pakënaqësive eventuale as në ditën e zgjedhjeve, as pas ditës së zgjedhjeve as në procesin e fillimit të numërimit të votave për kandidat në QKN, dhe se për këtë KKZ nuk ka hasur në asnjë provë apo dëshmi eventuale për apo lidhur me pretendimet e palës ankuese, dhe se deklaramet e vëzhgueses Ardiana Isufi, janë bërë vetëm pasi është mbyllur kutia e votimit nga KKZ-ja, e njëjta është dashur që në momentin e parë të raportonte tek KKZ, nga ky fakt vërtetohet nga KKZ e komunave, nuk ka të drejtë ta hap kutinë e votimit për të bërë vlerësim të fletëvotimeve.

Paneli, vlerëson se parashtruesja e ankesës në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara, se kishte disa fletëvotime të pavlefshme te pjesa e kandidatëve për deputet dhe në të cilat ishte prezentë edhe Nr. 51 me te cilin numër ka garuar Petrit Hajdari - kandidat për deputet, për të cilat dyshojnë që votat i janë dëmtuar. Ndërsa nga përgjigja e dhene nga KQZ lidhur me kete pretendim ankimor te parashtrueses se ankeses eshte potencuar fakti se gjatë numërimit të votave për kandidat në QKN, nuk ka pasur asnjë vërejtje as në ditën e zgjedhjeve, as pas ditës së zgjedhjeve as në procesin e fillimit të numërimit të votave për kandidat në QKN, dhe se për këtë KKZ nuk ka hasur në asnjë provë apo dëshmi eventuale për apo lidhur me pretendimet e palës ankuese, dhe se deklaramet e vëzhgueses Ardiana Isufi, janë bërë vetëm pasi është mbyllur kutia e

votimit nga KKZ-ja, e njëjta është dashur që në momentin e parë të raportonte tek KKZ, ndersa KKZ e komunave, nuk kanë të drejtë ta hapin kutinë e votimit për të bërë vlerësim të fletëvotimeve.

Në rastin konkret paneli vlerësoi se një pretendim i tillë i përgjithësuar është tërësisht i pa bazuar dhe i pa argumentuar, për faktin se pala ankuese nuk ka ofruar asnjë dëshmi, qoftë ndonjë formular apo dëshmi tjetër që do të bënte besueshëm pretendimin ankimor, andaj mbi një gjendje të tillë të fakteve paneli e refuzoi ankesën në tërësi si të pa bazuar.

Prandaj duke u mbështetur në nenin 117 paragrafi 3 të LZP-së, i cili përcakton se "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*", Paneli vlerësoi se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi, parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetojë pretendimet e tij.

Paneli gjatë vendosjes së ankesës i ka shqyrtuar dhe hetuar me kujdes të gjitha provat dhe ka vërtetuar në mënyrë të plotë se pretendimet ankimore janë të pa bazuar në ligj, andaj ankesa u refuzua e pa bazuar në kuptim të nenin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe mbi këtë arsye paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës  
Anr.595/2025, datë 18.02.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.